



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Ministri

954 Prot.

Tiranë, më 16.9. 2014

**URDHËR**

Nr. 363, datë 16.9.2014.

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E NIVELIT ARSIMOR TË MËSUESIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE  
TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Në institucionet arsimore të sistemit arsimor parauniversitar, të gjithë mësuesit që janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë apo të pjesshme, të zotërojnë diplomën universitare në fushën e edukimit ose të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të nenit 57 dhe 72 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
2. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore të marrin masat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me mësuesit pa arsim përkatës në të gjitha rastet kur ata rezultojnë në marrëdhënie pune me kohë të plotë apo të pjesshme në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar.
3. Mësues pa arsim përkatës të konsiderohen të gjithë ata mësues që nuk plotësojnë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në nenet 57 dhe 72 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

4. DAR/ZA-të të marrin masat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me mësuesit, të cilët rezultojnë në marrëdhënie pune me kohë të plotë, por që nuk kanë ngarkesën mësimore në përputhje me profilin e diplomës së mësuesisë që ata zotërojnë.
5. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës për rastet e mësipërme, të bëhet sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në Kodin e Punës.
6. DAR/ZA, për rastet kur ngarkesa mësimore e lëndës nuk është e plotë, të marrin masat që marrëdhënia e punës me mësuesin të jetë me kontratë me kohë të pjesshme. Në çdo rast, kontrata me kohë të pjesshme e punës të nënshkruhet me mësues që zotërojnë diplomë universitare të lëndës dhe që plotëson kërkesat e neneve 57 dhe 72 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
7. Për zbatimin e këtij urdhri, DAR/ZA të raportojnë te Sekretari i Përgjithshëm në MAS brenda datës 26.9.2014
8. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe DAR/ZA-të

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**LINDITA NIKOLLA**

  
**MINISTËR**

